

Shoqata Humanitare “Jetimat e Ballkanit”, në vazhden e aktivitetit të saj humanitar, këtë javë ka ndihmuar familjen e Feride Fazlije - Rokës, e cila jeton në lagjen “Dërgut Vokshi” në Komunën e Gjakovës.

Kushtet në cilat jeton Feridja, me dy fëmijët e saj (vajzën Qerimen dhe djalin Azemin), të cilët janë jetimë, pa baba, janë vërtetë të mjerueshme.

Ata jetojnë në një kasolle prej druri, në të cilën është e pamundur të bëhet një jetë normale.

E zonja e shtëpisë, Feridja, mbi të cilën ka rënë e tërë barra e familjes, lutet që ta kenë një kulm të sigurt mbi kokë, raporton Telegrafi.

“I lutem Zotit që ta kem një kolibe të vogël, që dikush do të na dalë në ndihmë”, ka thënë ajo.

Në vazhdim mund ta shikoni videon, që pasqyron kushtet e rënda të jetesës së kësaj familjeje.